



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Pogradec, më 14.10.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**Pune Ndertimore 45;
Pune Ndertimi 45000000 – 7;
Punime betony 45262300-4**

VLERA E FONDIT LIMIT:

220 320 000 (Dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat në pikat “a” dhe “b” bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars

të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.“

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të** vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
 - NP 1 – A Punime germimi ne toke
 - NP4- D Rruge,autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
 - NP 5 –B Punime nentokesore, ura e vepra arti
 - NP 9-A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime
- N.P.11-A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS 1 – A Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S 5 – A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
- N.S 7– A Barriera dhe mbrojtje rrugore
- N.S 18 - A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Kategori a e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
-------------------------------	---	--	--	--

NP.1-A Punime gërmimi në tokë	Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	Punime dherash, prishje dhe riparime	Niveli A	18 613 481 lekë pa tvsh
N.P.4-D Rrugë a, ura, mbikali me, hekurud ha, linja tramvaj, metro, hekurud hë me kavo dhe pista aeroport uale.	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.	Punime shtresash ne rruge Punime trotuari	Niveli D	141 972 695 leke pa tvsh
N.P. 5-B Punime nëntokës ore	Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të	Tombino betoni Ø 600 mm	Niveli B	38 180 096 leke pa Tvsh

	<p>lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.</p>	<p>Tombini betoni Ø 300 mm me puseta shi ujembledhese Tombino katrore 2*2 m (ura) Mure mbajtëse betoni C25/30</p>		
<p>NP 9 – A Punime mbrojtje lumore, sistemim e hidraulik e dhe bonifikasi me</p>	<p>ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrore ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.</p>	<p>Kanalizimet e Ujerave te Bardha (KUB)</p>	<p>Niveli A</p>	<p>4 250 970 leke pa tvsh</p>

<p>N.P.11 Ndërtim e për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike</p>	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.</p>	<p>Punime për spostimin e shtyllave</p>	<p>Niveli A</p>	<p>7 221 660 leke pa Tvsh</p>
<p>N.S 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve</p>	<p>Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.</p>	<p>Prishje struktura Guri Prishje struktura Betoni</p>	<p>Niveli A</p>	<p>269 964 leke pa Tvsh</p>
<p>N.S – 5A Impiante të sinjalistikës ndriçuese e të trafikut</p>	<p>Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.</p>	<p>Punime sinjalistike rrugore vertikale dhe horizontale (vijezime dhe tabela)</p>	<p>Niveli A</p>	<p>4 073 292 leke pa Tvsh</p>

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa	Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W2 + aksesori	Niveli A	1 677 805 leke pa Tvsh
N.S - 18 Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh	Matje topogjeodezike për germimet e themeleve, të mureve mbajtëse, tombinove, shtresave rrugore	Niveli A	4 060 037 leke pa Tvsh

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)
- Inxhinier Topograf 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në Listëpagesat të pakten për periudhën Korrik – Shtator 2022 si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diplomat përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezultojnë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Inxhinieri i mjedisit është vendosur me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit të lidhur ngushtësisht me punimeve e parashikuara në preventiv dhe përshkrimin e relacionit teknik

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Fushat e Ekspertizes qe mbulojne inxhinieret e mesiperm:

Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)	Inxhinieri i ndertimit eshte i domodoshem ne te gjitha zerat e punimeve, si me poshte: <ul style="list-style-type: none"> - Punimet e shtresave - Punime trotuari - Punime vegla te vogla arti Nga Ak kerkohen 2 inxhinieret ndertimi per shkak te shtirjes se gjera gjeografike prej 10 km si dhe terrenit malot ne objekt
Inxhinier Hidroteknik 1 (një)	- Punime KUB, te cilat zene nje pjese te konsiderueshme te volumit te punimeve te parashikuara ne objekt, konkretisht 1700 ml shtrirje te kanalizimeve te ujerave te bardha
Inxhinier Elektrik 1 (një)	- Punimet e ndricimit te rrugeve ne zonat e banuara te objektit, konkretisht 3500 ml shtrirje te linjes elektrike
Inxhinier Gjeolog 1 (një)	Nevojitet per mbikqyrjen e terrenit gjate punimeve te germimit per muret mbajtese, tombinot dhe germimit qe do te behet ne trupin e rruges, duke pasur parasysh se ne Uren e Zemces kane ndodhur rreshqitje te shpatit te malit gjate punimeve ne aksin rrugor Qukes – Qafe plloce.

Inxhinier Topograf 1 (një)	Nevojitet per piketim gjate germimit te punimeve ne trupin e rruges, ne shtresat rrugore, ne piketimin dhe zbatimin e kanalizimeve te ujerave te bardha, ne linjat elektrike dhe ne piketimin e veprave te vogla te artit
Inxhinier Mekanik 1 (një)	Eshte i domosdoshem ne kantier per shkak te pranise se nje numri te madh makinerish dhe pajisjesh gjate gjithë kohezgjatjes se objektit dhe ka nevojë per gjetjen e difekteve te ndryshme te makinerive dhe riparimin e tyre sepse objekti ndodhet ne nje distance mbi 40 km larg zones se banuar te qytetit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën korrik - shtator 2022 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" (i ndryshuar), VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" (i ndryshuar) i cili përcakton "2/1. Punedhenesi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nepermjet mjekut të ndennarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja,

juridike ose fizike dhe12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të kësaj vendimi, marrja në punë e mjekut të ndennarrjes është e detyrueshme për ato ndennarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës ... Mjeku i ndennarrjes ofron keshillimin e tij për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të semundjeve profesionale, si dhe për të gjitha ceshtjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai vlerëson ceshtjet të fiziologjia se punës, të problemeve higjienike e sanitare, vecanerisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij

neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës të disponojnë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

Argumentimi 2.3.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 ... Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institutcion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 77 (shtatedhete e shtate) persona për periudhën korrik - shtator 2022 e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën korrik - shtator 2022.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën korrik - shtator 2022.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje maj-korrik 2022, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të

punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Kete perlllogaritje si nevoje e transparencies ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

I-PROJEKT ZBATIMI I RRUGES (KYQEZIM – SLABINJE)

Nr	Nr An	Pershkrimi i zerit	Njesi	Sasia	Op/Njesi	Op/total
PERMBLEDHJE						
1	Kat.1	Punime dherash,prishje dhe riparime				
2	Kat.2	Punimet e Shtresave				
3	Kat.3	Punime Trotuari				
4	Kat.4	Punime KUB				
5	Kat.5	Punime Elektrike				
6	Kat.6	Veprat e Vogla te Artit				
7	Kat.7	Punime Sinjalistike				
8		SUBTOTAL 1-7				
9		Fond Rezerve 2 %				
10		SUBTOTAL				
11		T V S H 20%				
12		TOTAL A				

KATEGORIA 1: PUNIME DHERASH,PRISHJE DHE RIPARIME

Nr	Nr An	Pershkrimi i zerit	Njesi	Sasia	Op/Njesi	Op/total
1	3.2	Prerje bime te vogla ø-10cm	m2	6,107.0	0.06	366.4
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm	cope	355.0	0.40	142.0
3	An-48	Prishje struktura prej guri	m3	85.0	1.00	85.0
4	An-49	Prishje struktura prej betoni	m3	21.0	1.75	36.8
5	An.	Spostim shtyllash elektrike	cope	8.0	2.00	16.0
6	3.159/e	Germim e transport toke e zakonshme,seksion i lire	m3	7,870.0	0.12	944.4
7	3.137	Germim toke e forte,seksion i lire	m3	2,235.0	0.23	514.1
8	3.161/1	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.5 m3	m2	2,100.0	0.10	210.0
9	An.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri per nivelete	m3	1,933.0	0.34	657.2
10	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	106.0	5.00	530.0
TOTAL Nr 1						3,501.8

KATEGORIA 2: PUNIMET E SHTRESAVE

1	3.209	Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	19,500.0	0.14	2,730.0
2	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm (rruga)	m2	18,600.0	0.075	1,395.0
3	3.212/a	Shtrese stabilizanti t=5cm (bankinat)	m2	2,725.0	0.05	136.3
4	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri	m2	15,850.0	0.109	1,727.7

5	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	15,850.0	0.162	2,567.7
TOTAL Nr 2						8,556.6
KATEGORIA 3: PUNIME TROTUARI						
1	3.25/a	Germim dheu per trotuare t=20cm me krahe toke e zak	m3	190.0	4.90	931.0
2	An.164/1b	Shtrese çakelli e gur gurore t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri per trotuar	m³	190.0	0.34	64.6
3	3.246	Beton per kuneta 0.50m, 0.0875m3/ml, C 16/20	m3	84.0	12.90	1,083.6
4	3.617/1	F V bordura betoni 15x30 cm	m	962.5	1.00	962.5
5	3.619/a	Bordura betoni 6x20 cm (per pemet)	ml	180.0	0.53	95.4
6	3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m2	950.0	2.14	2,033.0
7	An164	F.V. Fidane Peme dekorative	cope	90.0	1.00	90.0
8	2.262/4	Shtrese betoni C16/20 poshte bordures 0.03 m3/ml	m3	28.800	8.60	247.7
9	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 (bordura e pasme)	m3	53.0	12.80	678.4
10	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	190.0	5.00	950.0
TOTAL Nr 3						7,136.2
KATEGORIA 4: PUNIME KUB						
1	3.104/b	Germim dheu me ekskavator 0.5 m³, b > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	400.0	0.10	40.0
2	An.164/1b	Mbushje me cakell	m3	125.0	0.34	42.5
3	3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	450.0	1.50	675.0
4	An	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm	ml	550.0	1.50	825.0
5	An - 23	Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	48.0	5.60	268.8
6	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	400.0	5.00	2,000.0
TOTAL Nr 4						3,851.3
KATEGORIA 5: PUNIME ELEKTRIKE						
1	3.An/53	F.V. shtylle metalike H=7 ml l=4mm	cope	36.0	1.80	64.8
2	3.An	F.V. ndriçues MINITONALE -SAP-T 250 W	cope	36.0	2.00	72.0
